

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI****VENDIM****Nr. 96 Datë 04.07.2017****MBI****SHTYRJEN E AFATIT TË VENDIMIT TË ERE-S NR 115, DATË 07.08.2016 “MBI
PËRCAKTIMIN E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87 pika 2 të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Vendimit nr. 449, datë 15.06.2016, të Këshillit të Ministrave, “Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike.” dhe nenit 8, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 04.07.2017, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi shtyrjen e afatit të vendimit të ERE nr.115 datë 07.08.2016 “Mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike:

Konstatoi se:

- Me Vendimin nr. 449, datë 15.06.2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar “Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike.”
- Në pjesën III, të VKM nr. 449, datë 15.06.2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar “Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike.” parashikohet se : *Deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit sipas këtij Vendimi, ERE cakton përkohësisht furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për të kryer detyrat e Furnizuesit të mundësisë së fundit.*
- Me VKM nr.244, datë 30.03.2016 janë miratuar “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.
- Në VKM nr. 244, datë 30.03.2016 është parashikuar se :*Detyrimi i shërbimit publik përfshin ndër të tjerë KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. ku kjo e fundit do të sigurojë blerjen e energjisë elektrike për qëllime të shërbimit universal nga KESH sh.a.*
- Me Vendimin nr. 195, datë 30.12.2016, Bordi i ERE vendosi mbi shtyrjen e afatit të Vendimit të ERE-s nr 115, datë 07.08.2016, mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike deri në 30 Qershor 2017.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Shtyrjen e afatit të përcaktuar në pikën 1 të Vendimit të ERE-s nr. 115, datë 07.08.2016, deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit sipas VKM nr. 449, datë 15.06.2016.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI